



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 21/2023 (JR)
Nr. 21/2 regj.

Tiranë, më 27.02.2025

SHPALLJE
E
NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË DHOMË KËSHILLIMI

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelit, bazuar në nenin 65, pika 1 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se **ditën e enjte, datë 10.04.2025, ora 10:00**, do të gjykohet në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit me numër regjistri (JR) 21/2023, datë 23.05.2023, për ankimin e subjektit të rivlerësimit Rexhina Merlika kundër vendimit nr. 635, datë 13.03.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Seanca në dhomë këshillimi do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykses përbëhet nga gjyqtarët:

Kryesuese e Trupit Gjykses	Albana Shtylla
Relatore e Çështjes	Natasha Mulaj
Gjyqtare	Mimoza Tasi
Gjyqtare	Rezarta Schuetz
Gjyqtar	Sokol Çomo

Bazuar në nenin 49 pika 2 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrimet me shkrim, lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Bazuar në nenin 482 paragrafi i tretë i Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, si dhe me njoftim individual në adresën elektronike alternative të subjektit të rivlerësimit. Ky njoftim bëhet gjithashtu dhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES
GJYQTARE

ALBANA SHTYLLA